



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 20. 05. 2009, ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Nerxhivane Dauti, Naim Rustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Vezira Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Mungoi: Ibrahim Makolli (në udhëtim zyrtar).

Të ftuar ishin: Shkumbin Bicaj - nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit, Izeir Qorrolli dhe Fehmi Baftiu – përfaqësues të sindikatës së IMK-së, Ferizaj, Ramadan Ademi - i Trepçës dhe Xhafer Xhaferi - nga BSPK.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Petrit Hysaj – OSBE, Artë Zogaj - Iniciativa Qytetare” dhe Nexhat Shatri.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinators dhe Visar Krasniqi

Kryetari - Vërejtje se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Takimi me përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe me kryetarët e sindikatës së “ IMK- së”, të Fabrikës së Gypave në Ferizaj dhe atë të Trepçës, që do ta informojnë Komisionin për mënyrën e privatizimit të ndërmarrjeve,
3. Shqyrtimi i Ankesës së F. A. nga Prishtina,
4. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Vërejtje: Pasi Ismet Beqiri ishte i zënë, pjesën e dytë të mbledhjes e udhëhoqi Hajredin Hyseni.

1 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2 Takimi me përfaqësuesit e AKP-së me kryetarët e sindikatës së IMK- së, të Fabrikës së Gypave në Ferizaj dhe atë të Trepçës, që do ta informojnë Komisionin për mënyrën e privatizimit të ndërmarrjeve.

Ismet Beqiri – I përshëndeti përfaqësuesit e AKP-së, të fabrikës së IMK-së, në Ferizaj dhe të KK të Trepçës dhe shtoi se punëtorët kanë shprehur shqetësimin për mënyrën e privatizimit të ndërmarrjeve të tyre. Ata e konsiderojnë procesin e zhvillimit të privatizimit të paligjshëm, ngase ka shkaktuar shqetësime të shumta te punëtorët. Me këtë rast ua rikujtoi se Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 08. 07. 2008, e ka pasur në shqyrtim peticionin e punëtorëve të sindikatës së IMK- së të Fabrikës së Gypave në Ferizaj dhe ka nxjerrë rekomandim, me të cilin e ka mbështetur aktgjykimin e Gjykatës komunale të Ferizajt dhe kërkoi të lejohet ekzekutimi i tij, prandaj e ftoi për ta marrë fjalën.

Fehmi Baftiu - avokat dhe përfaqësues i punëtorëve të IMK- së, kërkoi zbatimin e vendimeve të gjykatave të instancave më të larta. Ai rastin e punëtorëve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj e kualifikoi shkëlqejte flagrante të të drejtave të punëtorëve në Kosovë, dhe ua përkujtoi të pranishmeve se lënda i është proceduar për shqyrtim Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat Njeriut në Strasburg. Në fund kërkoi zbatimin e vendimeve të plotfuqishme qoftë pozitive ose negative.

Izeir Qorrolli – Ishte i një mendimi me ta dhe lidhur me çështjen e punëtorëve shtoi se nuk është përfillur procedura e politikave operacionale dhe as e atyre ligjore. Në privatizimin e saj në raundin e -19- të, kishte konkurrar vetëm një kompani. Ishin penguar në konkurrim kompanitë më eminente.

Ramadan Ademi –përfaqësues i punëtorëve të Xeherores së Trepçës – Tha se kjo çështje duhet të procedohet në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa sa i përket privatizimit shtoi se nuk është mirë të jepen në këtë mënyrë pasuritë e Kosovës dhe klasa punëtore të mbetet rrugëve.

Shkumbin Bicaj - nga **AKP** - Tha se nuk mund të pajtohet që është bërë diskriminim në ndërmarrjen **IMK**. Diskriminimi nuk është bërë nga kjo agjenci e as nga kjo Qeveri. Ndërmarrja në fjalë është privatizuar me” spinof special”. Në vija të trasha e paraqiti kronologjinë e privatizimit. Lidhur me këtë çështje anëtarët e Komisionit shtruan pyetje dhe morën përgjigje.

Ndërsa lidhur me Trepçën theksoi se është çështje më e ndërlikuar dhe se është marrë subvencion nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Me këtë rast u fol për pensionet e parakohshme. Trepça që tre vjet është nën vendimin e moratoriumit, që e suspendon çfarëdo procedure të gjykatës, me qëllim të mbrojtjes ndaj pretendimeve të ndryshme. Në fund tha se Trepça është nën administrimin e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme.

Sanije Alijaj – Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve lidhur me statusin e pazgjedhur të punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve, shtroi pyetjen: cila do të ishte strategjia e Agjencisë për t'i mbrojtur këto pasuri kombëtare?

Drita Maliqi - Tha se privatizimi në Kosovë ka dështuar. Dhe pyeti: Agjencia a ka ndonjë strategji të mbrojtjes së punëtorëve? A është privatizuar menaxhmenti apo pasuritë natyrore të papërpunuara?

Vezira Emrush –Gjatë procesit të zbatimit të privatizimit ka pasur parregullsi në disa ndërmarrje dhe është bërë diskriminim i punëtorëve, sidomos të Trustit Pensional. Duke iu referuar Rregullores së UNMIK – ut nr. 2003/13 tha se qëllimi ka qenë të ruhen dhe të zhvillohen këto ndërmarrje. Pastaj shtoi se ekspertët e ndryshëm e kanë përcaktuar vlerën e këtyre ndërmarrjeve dhe nuk është realisht në proporcion me atë që është shitur. Pyeti pse nuk janë ndarë mjete për 20 % brenda afateve të parapara me Rregullore? Dhe vetë u përgjigj tërthorazi se nuk janë përfillur interesat e punëtorëve në procesin e privatizimit. Në fund pyeti: a ka pasur program social për punëtorët që ishin në këto ndërmarrje?

Luljeta Shehu – Kërkoj sqarim lidhur me personat që kanë punuar në këto ndërmarrje dhe më vonë kanë vdekur. Ajo pyeti: a u takon 20 përqindëshi këtyre punëtorëve?

Pas një diskutimi të gjerë dhe konstruktiv të zhvilluar nga të pranishmit Komisioni vendosi të nxjerrë këtë

P ë r f u n d i m

Në mbledhjen e radhës të shqyrtohen vërejtjet e sugjerimet dhe në bazë të tyre të nxirren rekomandimet përkatëse për t'i informuar ankuesit me përmbajtjen e tyre.

3. Shqyrtimi i Ankesës së F. A. nga Prishtina

Hajredin Hyseni – kryesues - E njoftoi Komisionin për ankesën dhe e ftoi raportuesen ta merrte fjalën.

Nerxhivane Dauti- në cilësi të raportuesit - Tha se e ka shqyrtuar ankesën e Ferhat Ashikferkit dhe ka ofruar zgjidhjen.

Meqë për këtë ankesë nuk pati diskutime Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni i sugjeron Ferhat Ashikferkit, në bazë të nenit 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për shërbyesit civilë dhe të Rregullores nr. 2008/12, për shqyrtimin e ankesës t'i drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 30.

Kryetar i Komisionit

Ismet Beqiri

